



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembl*

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 26. 12.2013, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10.

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e Komisionit:** Suzan Novoberdali, kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Justina Shiroka - Pula, Kymete Bajraktari, Albana Gashi dhe Kimete Bytyçi dhe Duda Balje.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Reshit Gashi, Zyrtar i lartë ligjor, Sulltane Gashi, zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit.

**Mbledhjen e kryesoi,** Suzan Novoberdali, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Marrja e vendimit për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

**Kryetarja** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me këtë pike të rendit të ditës.

1. Marrja e vendimit për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

**Kryetarja**- tha se këtë mbledhje të shkurtër e kemi thirrur sot për të miratuar vendimin që të shpallet konkursi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, duke u bazuar në nenin 1, të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit, në mbledhjen e mbajtur më 26 dhjetor 2013, unanimisht mori këtë

#### VENDIM

1. Shpallet konkursi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit;
2. Konkursi do të publikohet, më 4 janar 2014, në mediat e shkruara dhe elektronike, në gjuhën shqipe, boshnjake, angleze, serbe dhe turke;
3. Afati për paraqitjen e kandidatëve është 20 (njëzet) ditë.
4. Kushtet e konkursit janë të përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit, neni 6.
5. Ngarkohet Administrata e Kuvendit për publikimin e konkursit dhe për veprimet tjera procedurale, në përputhje me rregulloren.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali